



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 38

Datë: 05. 12. 2022. Ora: 16:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Vesa Xharra, drejtoreshë u.d., e ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr. 31, 36 dhe 37/2022

3. Aktivitetet e SKQZ-së

4. Raport nga Zyra:

-Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzuesit për tërheqjen e shortit

5. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i analizës dhe Vlerësim i Qendrave të Votimit në Kosovë
- Shqyrtimi dhe miratimi i analizës e Votave me Kusht për Zgjedhjet Lokale 2021
- Shqyrtimi dhe miratimi i analizës Gjimore dhe Moshës së Lidershipit të Partive Politike: 2017-2021
- Shqyrtimi dhe miratimi i Trendëve Zgjedhore 2009-2021

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarëve të Kuvendit Komunal në Zubin Potok

6. Të ndryshme

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka filluar me përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar në komunat Mitrovcië e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok.

Në fillim, pasi kemi pranuar dorëheqjet e katër Zyrtarëve të Lartë Komunal të Zgjedhjeve të këtyre katër komunave, ne kemi vlerësuar hapat ligjor që duhet ndërmarrë. Pas situatës së re të krijuar, janë caktuar katër Ushtrues Detyre, nga një për secilën komunë, e të cilët janë Zyrtarë të Lartë Komunal të Zgjedhjeve nga komunat tjera.

Pas caktimit të katër Ushtrues Detyre të ZLKZ-ve në këto komuna, ne kemi ndërmarrë hapat tjerë për ndërtimin e trupës zgjedhore, Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve. Me kohë i kemi dorëzuar ftesat për nominimin e anëtarëve, ashtu siç kërkohet me ligj. Me 28 nëntor, KQZ-ja ka themeluar katër Komisionet Komunale të Zgjedhjeve.

Me qëllim të funksionalizimit të këtyre zyreve, ashtu siç është dakorduar KQZ-ja në mbledhje, i kemi dërguar shkresë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës, prej të cilave kemi kërkuar vlerësim të situatës dhe ofrimin e sigurisë për zyrtarët e KQZ-së dhe katër Komisioneve Komunal të Zgjedhjeve, në secilën zyre, gjatë gjithë kohës së ushtrimit të detyrave zyrtare.

Funksionalizimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve është i domosdoshëm në kuadër të përgatitjeve për mbajtjen e zgjedhjeve, sepse këto komisione kryejnë disa detyra të rëndësishme të përcaktuara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Pra, sipas ligjit, KKZ-ja është organ përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore brenda territorit të komunës, nën mbikëqyrjen ekskluzive dhe udhëzimet e KQZ-së që vepron përmes Sekretariatit, duke garantuar ligjshmëri, legjitimitet dhe efikasitet të procesit zgjedhor. Disa nga këto detyra kanë të bëjnë me vlerësimin e qendrave të votimit dhe depos kryesore ku dërgohet materiali zgjedhor, përgatitja e listës së nominimeve për anëtarë të Këshillave të Vendvotimeve, pranimi dhe shpërndarja e materialeve zgjedhore, e të tjera.

Përveç Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës, i kemi dërguar shkresë Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, nga ku kemi kërkuar mundësimin e shfrytëzimit të shkollave në këto katër komuna në mënyrë që ato të përdoren si Qendra Votimi më 18 dhjetor dhe 25 dhjetor 2022. Me datë 30 nëntor, ne kemi pranuar një përgjigje nga MASHTI. Në këtë përgjigje, MASHTI jep pëlqimin për mbajtjen e zgjedhjeve në këto shkolla. Në fund të shkresës, në funksion të zbatimit të këtij pëlqimi, MASHTI na inkurajon për koordinim me nivelin lokal, përkatësisht me institucionet arsimore ku planifikohet mbajtja e zgjedhjeve.

Në takimin e sotëm që Kryetari i KQZ-së dhe Kryshefi Ekzekutiv i SKQZ-së ka pasur me Policinë e Kosovës, jemi dakorduar për hapat e mëtutjeshëm për ofrimin e sigurisë për zyrtarët e KQZ-së dhe KKZ-në.

Periudha e Aplikimit për Regjistrim të Votuesve jashtë Kosovës

Bazuar në Vendimin nr. 01/ 1361 – 2022, i datës 15.11.2022 për caktimin e afateve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave në Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan

2022, Periudha e Aplikimit për Regjistrim të Votuesve jashtë Kosovës është zhvilluar nga data 26.11.2022 deri me datën 30.11.2022.

Para fillimit të kësaj periudhe, KQZ ka dërguar e-mailat njoftues dhe aplikacionet për 66 votues të cilët kishin aplikuar suksesshëm për regjistrim për votim jashtë vendit në Zgjedhjet Lokale 2021. Pra, janë dërguar aplikacione për regjistrim për votim jashtë Kosovës :

56 votuesve jashtë Kosovës, të komunës së Zubin Potokut,

2 votuesve jashtë Kosovës, të komunës së Zveçanit,

8 votuesve jashtë Kosovës, të komunës së Mitrovicës së Veriut.

Pranimi i aplikacioneve për regjistrim

Përgjatë Periudhës së Aplikimit për Regjistrim të Votuesve jashtë Kosovës (26 – 30 nëntor 2022) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka pranuar gjithsejtë: tri (3) aplikacione për regjistrim.

Të tri aplikacionet për regjistrim, janë pranuar në e-mailin për këtë qëllim: ovpp@kqz-ks.org.

Nga tri (3) aplikacione për regjistrim që janë pranuar dhe proceduar:

Janë aprovuar: tri (3) aplikacione për regjistrim, të tre aplikuesit janë shtetas të Republikës së Kosovës: Gjermani, 1 aplikacion dhe Suedi, 2 aplikacione.

Tabela 2: Numri i aplikacioneve të aprovuara sipas komunave të Republikës së Kosovës: Leposaviq 0 aplikim, Zubin Potok zero, Zveçan zero, Mitrovicë e Veriut 3 aplikime.

Sekretariati i A-WEB me datë 1 dhjetor 2022 ka dërguar deklaratën e bilancit për pagesën dhe përdorimin e tarifës së anëtarësisë për 2021 dhe 2022 për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës.

Arsyeja për këtë është se tarifat e papërdorura nga viti 2021 do t'i dhurohen A-WEB, sipas vendimit të marrë në Mbledhjen e 4-të të Asamblesë së Përgjithshme.

A-WEB: Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me pasqyrën e bilancit, mos ngurroni të kontaktoni Sekretariatit e A-WEB.

Bashkangjitur: kuota e anëtarësisë, pasqyra e bilancit për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve / Republika e Kosovës.

- Furnizimet dhe shërbimet për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendin Komuna

Sekretariati i KQZ-së është në fazën e zhvillimit të procedurave për furnizime dhe shërbime për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendin Komuna. Aktualisht një pjesë e aktiviteteve të prokurimit kanë kaluar fazën e vlerësimit dhe janë para nënshkrimit të 4 kontratës dhe pjesa tjetër janë në procesin e vlerësimit teknik të ofertave.

- Periudha e Shërbimit të Votuesve për ndërrimin e Qendrave të Votimit

Në kuadër të përgatitjeve për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave në Komunat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, që do të mbahen me datën 18 dhjetor 2022 është mbyllur periudha e Shërbimit të Votuesve për ndërrimin e Qendrave të Votimit

Periudha e shërbimit të votuesve për ndërrimin e qendrave të votimit ka filluar me datën 29.11.2022 dhe ka përfunduar me datën 04.12.2022. Para fillimit të kësaj periudha, janë publikuar të gjitha njoftimet në ueb faqen e KQZ-së dhe gjithashtu është publikuar lista preliminare e votuesve në platformën online “Gjeni qendrën tuaj të votimit”. Deri në orën 23:00 të datës 29.11.2022, përmes platformës online, është parashtruar vetëm një kërkesë për ndërrimin e qendrës së votimit.